



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE

KONKURS PUBLIK PËR DIZAJNIMIN E LOGOS së ZKA-së

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës, shpall konkurs dhe u bën thirrje të gjithë të interesuarve që të bëhen pjesë e garës për dizajnimin e Logos, së ZKA-së.

Konkursi është i natyrës garuese dhe ideja më e mirë e përzgjedhur do të shpërblehet me 950€.

Të gjitha të drejtat intelektuale mbi logon e përzgjedhur, përpunimi dhe përdorimi i saj, barten nga autori tek Zyra Kombëtare e Auditimit.

Vlerësimi i propozimeve do të bëhet nga një komision profesional i themeluar nga Auditori i Përgjithshëm.

Aplikuesit, gjatë ideimit të logos duhet të ketë parasysh kërkesat e mëposhtme.

Logoja duhet të:

- Jetë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- Jetë kuptimplotë dhe të shprehë funksionin, mandatin dhe detyrat e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA);
- Ketë një pasqyrim artistik të veprimtarisë së ZKA-së;
- Jetë unike, të reflektojë vizionin, misionin dhe vlerat e ZKA-së;
- Kuptohet lehtësisht dhe të përçojë mesazh të qartë;
- Jetë e dallueshme, që i reziston kohës dhe e lehtë për tu mbajtur në mend;
- Jetë lehtë e përshtatshme në dokumente fizike dhe në paraqitje elektronike, në internet dhe në shtyp, në sfonde të bardha dhe të errëta;
- Jetë e qartë edhe në madhësi të ndryshme, p.sh. shumë të vogël (vizitkarta) ose madhësi shumë të mëdha (billboard); dhe

Logoja do të përdoret krahas stemës shtetërore prandaj vizualisht dhe artistikisht nuk duhet të krijojë duplikim të simbolit shtetëror. Dizajnet duhet të dorëzohet në pliko të mbyllur e cila brenda duhet të përmbajë:

- Punimet e printuara dhe në CD, krahas duhet bashkangjitur edhe një manual të shpjegimeve të përmbajtjes dhe përdorimit;
- Punimet duhet të përmbajnë vetëm një kod/shifër identifikuese dhe jo të dhënat personale të autorit;
- Të dhënat personale të autorit duhet futur në një zarf tjetër të vogël i cili hapet vetëm pas përzgjedhjes së logos;
- Një autor mund të aplikojë me më shumë se një ide;
- Nëse një autorë aplikon me më shumë se një ide, aplikimi bëhet me pliko të veçantë dhe kod/shifër të veçantë;
- Të drejtë konkurimi kanë të gjithë artistët nga Kosova, rajoni dhe bota;

- Punimet konkurruese nuk do të ju kthehen autorëve.

Punimet duhet të dorëzohen në pliko të mbyllur që i adresohet:

PËR: Zyrën e Prokurimit
Zyra Kombëtare e Auditimit
Rr. Musine Kokollari 87
10000 Prishtina, Kosova

REF: Konkursi për dizajnimin e logos së ZKA-së

Vlerësimi bëhet nga komisioni profesional i emëruar nga Auditori i Përgjithshëm. Komisioni nuk do të ketë qasje në informatat personale të aplikuesve.

Konkursi është i hapur 21 ditë kalendarike, prej datës **07 prill 2018** deri me **28 prill 2018**, ora **16:00**.

Për informata shtesë ju mund të kontaktoni: jehona.krasniqi@oagks.org

Informata lidhur me mandatin, funksionin dhe detyrat e Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit 05/L-055, Auditori i Përgjithshëm është i pavarur nga ana funksionale, financiare dhe operative dhe nuk i nënshtrohet urdhrimit ose ndikimit nga cilido person apo institucion tjetër. Auditori i Përgjithshëm si kreu i Zyrës Kombëtare të Auditimit, i jep llogari Kuvendit për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë, në ligj, aktet nënligjore dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit publik. Në përputhje me këtë, Auditori i Përgjithshëm ka liri të plotë veprimi në kryerjen dhe ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave, në veçanti nuk i nënshtrohet kurrfarë urdhri për sa i përket auditimeve që duhet të kryhen, mënyrës si të bëhet një auditim dhe përparësisë që duhet dhënë një çështje të caktuar.

Zyra Kombëtare e Auditimit zbaton mandatin e saj në pajtim me Kushtetutën, Ligjin dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, kryen auditime dhe ushtron funksionet e saj në mënyrë të pavarur nga çdo organ apo autoritet tjetër i Republikës së Kosovës; ka buxhetin e saj të cilin e administron në mënyrë të pavarur dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi; jep rekomandime dhe kontribuon në menaxhimin e e shëndoshë të buxhetit dhe fondeve tjera publike; promovon standardet e larta për transparencë dhe llogaridhënie në menaxhimin financiar dhe performancën e administratës publike; dorëzon raportet e auditimit tek Kuvendi dhe entitetet e audituara.

Vizioni i Zyrës Kombëtare të Auditimit: *“Institucion i besueshëm i auditimit që përmirëson qeverisjen në sektorin publik në interes të qytetarëve”*

Misioni: *“Përmes auditimeve cilësore fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare”.*

Vlerat e Zyrës Kombëtare të Auditimit: *Pavarësia, Profesionalizmi, Integriteti dhe Transparenca.*

Për më shumë ju lutem shihni [Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës 05/L-055](#) dhe vizitoni faqen tonë www.oag-rks.org